

fq. 2-3 AMF organizon *workshop* të përbashkët me përfaqësues nga Autoriteti i Shërbimeve Shtetërore të Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Gjeorgjisë

VËSHTRIM MBI TREGJET

- » Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-tetor 2014 *fq. 4*
- » Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 30 shtator 2014 *fq. 5*
- » Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 30 shtator 2014 *fq. 6*

ZHVILLIME TË TJERA

- » Tryezë e rrumbullakët me temë "Ndërmjetësit në sigurime" *fq. 7*
- » Seminar mbi çështje të tregtimit të portofolit të instrumenteve financiarë dhe infrastrukturës së tregut *fq. 8*
- » Seminar për audituesit e brendshëm mbi investigimin, zbulimin dhe parandalimin e mashtrimit *fq. 9*

LAJMET NGA RAJONI

- » Bosnje Hercegovina » Ukrainë » Mali i Zi *fq. 10-12*

STUDIME DHE BOTIME

- » IOSCO publikon raportin e konsultimeve për rregullimet ndërkufitare *fq. 13*

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

AMF organizon *workshop* të përbashkët me përfaqësues nga Autoriteti i Shërbimeve Shtetërore të Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Gjeorgjisë




Gjatë zhvillimit të workshopit me përfaqësues nga Autoriteti i Shërbimeve Shtetërore të Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Gjeorgjisë

Në datat 11-12 nëntor Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi *workshopin* "Mbikëqyrja dhe rregullimi i tregut të sigurimeve në Shqipëri" me përfaqësues nga Autoriteti i Shërbimeve Shtetërore të Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe Parlamenti i Gjeorgjisë, të cilët ishin për një vizitë pune në Tiranë. Ekipi nga Gjeorgjia kryesohej nga Z. Ioseb (Kakha) Gogolashvili, Nënkyetar i parë i këtij institucioni.

Organizimi i këtij *workshopi* u iniciua nga autoriteti i Gjeorgjisë me synimin për të marrë eksperiencën shqiptare në drejtim të mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregut të sigurimeve, më specifiku zhvillimet në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik. Ekspertët e AMF-së në këtë *workshop* prezantuan tek specialistët e autoritetit të Gjeorgjisë sfidat në mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregut të sigurimeve dhe zhvillimet e fundit që AMF po ndërmerr, bazuar në eksperiencën dhe zgjidhjet praktike, të mbështetura edhe në rekomandimet e organizmave ndërkombëtare për këtë treg.

Duke përshëndetur *workshopin*, Kryetarja e AMF-së znj. Enkeleda Shehi, bëri një përshkrim të shkurtër të tregjeve që AMF mbikëqyr dhe peshës që ato zënë në tregun financiar të vendit. Ajo nënvizoi dhe zhvillimet e fundit legjislative, ndryshimet në ligjin për AMF-në dhe aprovimin e ligjit për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit. Ajo i vlerësoi këto si zhvillime pozitive, të mirëpritura, që do të forcojnë më tej AMF-në nga pikëpamja institucionale dhe do të rrisin rolin e saj mbikëqyrës e rregullator në fushën e sigurimeve, duke ecur drejt mbikëqyrjes me fokus rrezikun.

Z. Ioseb (Kakha) Gogolashvili prezantoi zhvillimet më të fundit të tregut të sigurimeve në Gjeorgji. Ai shpjegoi ecurinë institucionale të tyre që prej vitit 1997 me hyrjen në fuqi të ligjit të parë të sigurimeve, përpjekjet për rritjen dhe zhvillimin e tregut të sigurimeve në vend dhe punën që po bëjnë për prezantimin e ligjit të ri për sigurimet motorike.



Gjatë *workshopit*, ekspertë të AMF-së prezantuan hapat dhe ecurinë institucionale të autoritetit, si dhe përpjekjet për rritjen e konsolidimit e pavarësisë institucionale si një bazë e rëndësishme për veprimtari të suksesshme mbikëqyrëse dhe rregullatore.

Çështje të tjera që u trajtuan si mjaft të rëndësishme për zhvillimin e tregut të sigurimeve ishin:

- » Sigurimi motorik përmes shifrave, fakteve dhe sfidave me të cilat ai përballet;
- » Qendra kombëtare e të dhënave të sigurimit të detyrueshëm motorik, regjistri elektronik online i shitjeve dhe i dëmeve;
- » Aspektet aktuariale në përllogaritjen e primeve dhe sistemi Bonus-Malus;
- » Byroja Shqiptare e Sigurimeve, aktiviteti i saj në mbrojtjen e konsumatorëve dhe Fondi i Kompensimit;
- » Analiza financiare e treguesve të shoqërive të sigurimit, metodologjia e përdorur dhe treguesit e paralajmërimit të hershëm;
- » Inspektimi në vend i shoqërive të sigurimit, objektivat dhe metodologjia;
- » Roli i audituesve të brendshëm pranë shoqërive të sigurimit;
- » Elemente të konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik.

Ish komisionerja e Autoritetit të Mbikëqyrjes së Bankave dhe Sigurimeve të shtetit të New Jersey, SHBA, me përvojë të gjatë në tregun e sigurimeve, znj. Holly Bakke, e pranishme gjithashtu në *workshop*, prezantoi mënyrat e komunikimit me publikun për ndryshimet dhe procesin e liberalizimit të çmimeve për sigurimin motorik.

Organizimi i këtij *workshopi*, përtej sfidave të vazhdueshme me të cilat tregu i sigurimeve të detyrueshme në vend përballet, e vendosin AMF-në në një rol të ri si model pozitiv i zhvillimit institucional, i fuqizimit të rolit mbikëqyrës dhe rregullator, duke ndarë eksperiencën me autoritetet e tjera homologe, të cilat përballen me sfida të ngjashme.

Vizita dhe *workshopi* shërbyen si hapa të parë për forcimin e marrëdhënieve midis dy institucioneve në drejtim të shkëmbimit të ideve dhe eksperiencave në interes të përbashkët.



VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-tetor 2014

Tregu i sigurimeve u rrit me 43.55% gjatë periudhës janar-tetor 2014. Vlera e primeve të shkruara bruto në këtë periudhë arriti rreth 9.50 miliardë lekë. Kjo u shoqërua me rritje të numrit të policave të sigurimit me 1.59% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 844,583 polica.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total regjistruan një ulje me 0.13% në krahasim me periudhën janar-tetor 2013. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 1.84 miliardë lekë, apo 83.12% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës gjatë periudhës janar-tetor 2014 u rrit me 48.18%, krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 5.61 miliardë lekë gjatë periudhës janar-tetor 2014, duke shënuar një rritje prej 84.85% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 59.21% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:


- » *Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë, të cilat zunë 15.32% të tregut të Jo-Jetës;*
- » *Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 11.71% të tregut të Jo-Jetës.*

Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin i Jetës u rritën me 8.64% krahasuar me periudhën janar-tetor të vitit 2013. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto të sigurimit të Jetës, afro 58.85% i përket sigurimit “Jetë debitor”.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-tetor 2014

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 30 shtator 2014

Gjatë nëntëmujorit të vitit 2014, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni. Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 30.09.2014 tregon një total asetesh neto prej 578.86 milionë lekë dhe me një rritje prej afro 144.04 milionë lekë (33.13%) krahasuar me fundin e vitit 2013. E shprehur në euro, totali i asetëve neto është 4.14 milionë euro (sipas kursit zyrtar të këmbimit më 30.09.2014 në Bankën e Shqipërisë, 1 euro=139.89 lekë, www.bankofalbania.org)

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve, më 30.09.2014 ishte 8,432 anëtarë duke shënuar rritje prej 6.91% krahasuar me fundin e vitit 2013.


Tregues të fondeve të pensioneve

<i>Përshkrimi</i>	<i>Vlera (mln. lekë)</i>		<i>Ndryshimi (në %)</i>
<i>Periudha</i>	<i>31.12.'13</i>	<i>30.09.'14</i>	<i>31.12.'13-30.09.'14</i>
Asetet neto të FP	434.82	578.86	33.13


Asetet neto dhe numri i anëtarëve sipas fondeve të pensioneve

<i>Fond Pensioni</i>	<i>Numri i anëtarëve në FP</i>	<i>Asete Neto (mln. lekë)</i>
SIGAL	3,948	276.99
RAIFFEISEN	2,582	223.83
SiCRED PENSION	1,902	78.04
TOTAL	8,432	578.86

Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensioneve,
30.09.2014 (në %)



Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensioneve,
30.09.2014 (në %)



Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 30 shtator 2014

Gjatë periudhës janar-shtator 2014, në tregun e Fondeve të Investimeve ushtruan aktivitetin e tyre dy fonde investimi, përkatësisht Fondi i Investimeve “Raiffeisen Prestigj” dhe Fondi i Investimeve “Raiffeisen Invest Euro”.

Sipas analizës së të dhënave për tregun e Fondeve të Investimeve në 30.09.2014, vlera neto e aseteve të fondeve, arriti mbi 63.80 miliardë lekë me një rritje prej 26.76% krahasuar me 31.12.2013.

Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione Qeveritare të cilët përbëjnë 77.49% të aseteve të fondeve, me rritje prej 17.21% krahasuar me 31.12.2013.

Numri i anëtarëve që kanë investuar në Fondet e Investimit më 30.09.2014 ishte 33,179.

ZHVILLIME TË TJERA

Tryezë e rrumbullakët me temë “Ndërmjetësit në sigurime”

Më datë 6 nëntor në Lubljanë, Slloveni, nën kujdesin e Qendrës së Ekselencës në Financë (CEF) dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Sllovenisë u organizua tryeza e rrumbullakët me temë “Ndërmjetësit në sigurime”. Tryeza mbledhi së bashku përfaqësues nga 9 vende të Ballkanit për të shkëmbyer eksperiencat e tyre lidhur me veprimtarinë e ndërmjetësve në sigurime.

Kjo tryezë synonte njohjen e pjesëmarrësve me kuadrin ligjor të licencimit, mbikëqyrjes dhe rregullimit të veprimtarisë së ndërmjetësve në sigurimeve në veçanti në Slloveni dhe më gjerë, në nivel evropian.

Në prezantimin e tij, Z. Sergei Simonit, nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Sllovenisë analizoi nevojën e hartimit të një kuadri të ri rregullator për veprimtarinë e ndërmjetësve në sigurime kjo edhe si nevojë e ndryshimit të industrisë së sigurimeve. Ai vlerësoi se ky proces ndryshimi duhet të fillojë me amendimin e IMD 1 (Direktiva për Ndërmjetësit në Sigurime) për sa kohë kjo direktivë ka nivel të njëjtë rregullimi dhe mbikëqyrje për ndërmjetësit, kërkesa të njëjta për të gjithë ndërmjetësit, si dhe një nivel minimal harmonizimi. IMD 1 duhet riparë pasi aplikohet vetëm për personat që ushtrojnë veprimtari ndërmjetësimi tek subjekte të treta në shkëmbim të një shpërblimi dhe nuk përfshin shitjen e drejtpërdrejtë si dhe shitësit, të cilët janë të punësuar pranë një ndërmjetësuesi në sigurime. Z. Simonit prezantoi IMD 2, direktivën e re për ndërmjetësimin në sigurime, e cila pritet të miratohet dhe të hyjë në fuqi në maj 2015.

Në sesionet e tjera përfaqësuesi i Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) bëri një përmbledhje të akteve ligjore për mbikëqyrjen e ndërmjetësve në sigurime nga këndvështrimi i kësaj organizate dhe analizoi zbatimin e ICP-ve (*Insurance Core Principals*) në mbikëqyrjen e ndërmjetësve.

Prezantime të tjera u bënë nga Z. David Cowna përfaqësues i EIOPA (*European Insurance and Occupational Pension Supervision*) i cili paraqiti zhvillimet legjislativë nga perspektiva e ndërmjetësve në sigurime.

Në këtë tryezë të rrumbullakët u prezantuan pjesë nga ligji i Serbisë që rregullon veprimtarinë e ndërmjetësve duke u dhënë kështu mundësinë të pranishmëve të njiheshin me praktikën e një vendi tjetër. Prezantime u mbajtën edhe nga disa shoqëri brokerimi që ushtrojnë veprimtari në Slloveni për të pasqyruar eksperiencat e tyre në veprimtarinë e përditshme dhe zbatimin e legjislacionit.

Seminar mbi çështje të tregtimit të portofolit të instrumenteve financiarë dhe infrastrukturës së tregut

Instituti për Stabilitet Financiar, pranë Bankës për Rregullime Ndërkombëtare (*Bank for International Settlements, BIS*) në bashkëpunim dhe me Organizatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Letrave me Vlerë, (IOSCO) organizua në periudhën 19-21 nëntor seminarin mbi çështjet e tregtimit të portofolit të instrumenteve financiarë dhe infrastrukturës së tregut.

Në këtë seminar morën pjesë 57 përfaqësues nga rreth 40 juridiksione të ndryshme, duke përfshirë edhe pjesëmarrës nga autoritetet rregullatore të vendeve të zhvilluara, si dhe përfaqësues të tjerë të tregjeve në zhvillim të rajonit të Evropës Juglindore.

Seminari u fokusua në zhvillimet më të fundit në fushën e mbikëqyrjes së tregtimit të instrumenteve financiarë, kërkimet e kryera nga Bordi i Stabilitetit Financiar (FSB), Komiteti i Bazelit mbi Mbikëqyrjen Bankare (BCBS) dhe IOSCO. Ndër të tjera u diskutua rishikimi i rregulloreve për tregtimin instrumenteve financiarë, si dhe roli i rregullatorëve për ecurinë e këtij tregu.

Sekretari i Përgjithshëm i IOSCO-s, Z.David Wright bëri një prezantim të zhvillimeve dhe sfidave të reja në rregullimin e tregut të letrave me vlerë. Ai evidentoi veçanërisht misionin që ka IOSCO si organizatë ndërkombëtare rregullatore, duke analizuar krizën globale financiare e shkaqet kryesore që sollën atë. Më pas ai evidentoi mësimet që dalin nga kjo krizë siç janë: forcimi i mbikëqyrjes së kujdesshme të kapitalit, menaxhimi i rrezikut, rritja e transparencës dhe vlerësimit, ndryshimet në rolin dhe përdorimet e normave të kredisë, forcimin e reagimit të autoriteteve për rreziqet e ndryshme, etj.

Ekspertët dhe përfaqësuesit e IOSCO-s diskutuan tematika të rëndësishme që lidhen me mbikëqyrjen e tregjeve të letrave me vlerë duke përfshirë:

- » Zhvillimet e fundit mbi punën e Komitetit të Bazelit mbi standardet e mbikëqyrjes bankare dhe tregut financiar;
- » Reformat e derivateve mbi banak (*over the counter derivats*);
- » Rishikimin e portofolit të instrumenteve financiare;
- » Standardizimin e strukturës së re për tregtimin e instrumenteve financiarë;
- » Rishikimin e modeleve të brendshëm dhe përqasjen e strukturës së re me perspektivën e industrisë dhe rreziqet në treg;
- » Transformimin e Aseteve në Letra me Vlerë;
- » Kapitalizimin e rrezikut të kredisë;
- » Sigurinë e të dhënave në rrjetet *Online (cyber security)*;
- » Sfidat dhe implementimi i MMoU-së.

Ky program ishte ndërtuar si një forum për shkëmbimin e praktikave më të mira për zhvillimin dhe rregullimin e tregut të letrave me vlerë, të prezantuara këto nëpërmjet punimeve dhe studimit të rasteve nga vende të ndryshme të botës.

Seminar për audituesit e brendshëm mbi investigimin, zbulimin dhe parandalimin e mashtrimit

Qendra për Ekselencë në Finance (*Center of Excellence in Finance, CEF*) Lubljanë, Slloveni organizoi në datat 18-20 nëntor seminarin me temë "Investigimi, zbulimi dhe parandalimi i mashtrimit". Në këtë seminar morën pjesë 22 auditues të brendshëm nga institucione rregullatore financiare të vendeve të Ballkanit dhe të Evropës Lindore, me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave të tyre.

Z. Didier Casier, Drejtor i Departamentit të Auditit të Brendshëm, në Bankën Qendrore të Belgjikës, ishte moderator i seminarit i cili e fokusoi atë në tre tema të ndryshme: rritja e ndërgjegjësimit kundër mashtrimit, parandalimi dhe zbulimi i mashtrimit si edhe hetimi ndaj mashtrimit dhe aplikimin e teknikave ligjore.

Në prezantimet e çështjeve teorike u theksua se shmangja e rrezikut nga mashtrimi kërkon planifikim rigoroz, punë në terren dhe standardizimin e proceseve të raportimit. Çdo aset dhe çdo proces duhet të ketë një përdorues të caktuar i cili ka autoritetin për kontrollin dhe përgjegjësinë për dështim dhe në këtë drejtim balanca midis autoritetit dhe përgjegjësisë është kritike. Kontrollat mund të funksionojnë vetëm kur ato janë të specifikuar.

Diskutimet më tej evidentuan se jo të gjitha mashtrimet mund të parandalohen, kështu që proceset e monitorimit duhet të veprojnë si një rrjet sigurie për të identifikuar problemet.

Një hetim për mashtrim duhet të jetë drejtuar nga objektivat dhe me një plan të qartë veprimi, i bazuar në parimin e gjetjes së të vërtetës me kosto-efektive. Ndër tematikat e tjera të trajtuara në seminar ishin:

- » Përcaktimi i llojeve të ndryshme të mashtrimit (*sipasACFE, Association of Certified Fraud Examiners*) dhe karakteristikat e tyre;
- » Kuptimi i faktorit njerëzor të mashtrimit (trekëndëshi i mashtrimit);
- » Mënyrat më efektive për të zbuluar mashtrimin;
- » Zbatimi dhe zhvillimi i procedurave të auditimit për të rritur mundësinë e zbulimit të mashtrimit, duke përfshirë të dhënat më me rrezik;
- » Mënyrat e kryerjes së një hetimi për mashtrim në përputhje me standardet ACFE dhe Kodin e Etikës.

Një seksion mjaft me interes ishte edhe ai i përvojave të ndryshme lidhur me praktikën më të mira në parandalimin e mashtrimit si duke testuar kontrollat më efektive kundër mashtrimit.

Seminari u dha pjesëmarrësve mundësi për të ndarë eksperiencat praktike, rastet e ndodhura në vendet e tyre, si dhe për të krijuar një rrjet bashkëpunimi dhe shkëmbimi informacioni për të parandaluar dhe luftuar mashtrimin në tregjet financiare.

LAJMET NGA RAJONI

BOSNJE-HERCEGOVINË

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve të Bosnje Hercegovinës, gjatë 9 mujorit të vitit 2014 shënoi vlerën 218 milionë euro për primet e shkruara bruto ose 7.8% më shumë krahasuar me një vit më parë.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës përbëjnë rreth 19.4% të totalit, afërsisht 42 milionë euro. Pjesën e mbetur e zënë klasat e sigurimit të Jo-Jetës. Rreth 10.8% të primeve të shkruara bruto i takojnë klasave të sigurimeve të pronës dhe 58% sigurimet motorike (sigurimet MTPL dhe Kasko të marra së bashku).

Vlera e përgjithshme e dëmeve të paguara nga siguresit është rritur me rreth 28% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke kapur vlerën 91.4 milionë euro. Nga ky total, 35 milionë euro i përkasin sigurimeve MTPL, 15.6 milionë euro i takojnë sigurimeve Kasko, 18.9 milionë euro në klasat e pronës dhe 12.8 milionë euro për sigurimin e Jetës.

UKRAINË

www.xprimm.com

Byroja e Sigurimit Motorik të Ukrainës (*Motor (Transport) Insurance Bureau of Ukraine, MTIBU*) duke filluar që nga 19 nëntor 2014, ka rritur tarifën e sigurimit të Kartonit Jeshil me 19%.

Byroja e Ukrainës ka rishikuar tarifën e sigurimit të Kartonit Jeshil për shkak të ndryshimeve të kursit zyrtar të këmbimit të monedhës vendase (Hryvnia UAH), me euron. Më herët, më 16 tetor 2014, ishte bërë një tjetër ndryshim i tarifave të Kartonit Jeshil.

Sipas të dhënave nga Agjencia e Sigurimeve të Malit të Zi, tregu i sigurimeve arriti vlerën 53.94 milionë euro për periudhën janar-shtator 2014, duke shënuar një rritje prej 0.35% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Tregu vazhdoi të mbetet serisht i orientuar në sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën mbi 84% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë sigurimet e Jetës me rreth 16%.

Gjatë periudhës janar-shtator 2014, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në vlerë 21.65 milionë euro, ose 13.27% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit 2013. Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë periudhës janar-shtator 2014 arritën vlerën 28.47 milionë euro, duke shënuar një rënie 1.89% më pak se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Produkti MTPL, në periudhën janar-shtator 2014, pati një rënie prej 0.80% të volumit të primeve të shkruara bruto krahasuar me periudhën janar-shtator 2013, duke arritur në vlerën 25.03 milionë euro.

Produkti Sigurim Kasko, në periudhën janar-shtator 2014 pati një rënie prej 9.14% të volumit të primeve të shkruara bruto krahasuar me periudhën janar-shtator 2013, duke arritur në vlerën 3.34 milionë euro.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, gjatë periudhës janar-shtator 2014, arritën në vlerën 7.39 milionë euro.



STUDIME DHE BOTIME

IOSCO publikon raportin e konsultimeve për rregullimet ndërkufitare

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) publikoi me 25 nëntor raportin e konsultimeve të grupit të punës të ngritur nga IOSCO për rregullimet ndërkufitare, të cilat përshkruajnë mjetet dhe sfidat e identifikuara për rregullimet ndërkufitare.

Raporti i konsultimeve përshkruan tre mjetet për rregullimet ndërkufitare që duhet të përdoren, ose që janë në shqyrtim, nga anëtarët e IOSCO-s për të ndihmuar në adresimin e sfidave me të cilat ata përballen në mbrojtjen e investitorëve të tregut, ruajtjen e cilësisë dhe reduktimin e rrezikut sistemik. Këto mjete do të sigurojnë bazën për hartimin e një grupi rregulloresh ndërkufitare dhe njëterminologjie të përbashkët, e cila përshkruan mundësitë e hapura për anëtarët e IOSCO-s për t'u konsultuar kur lind nevoja e rregullimeve ndërkufitare. Ato mund të klasifikohen në tre kategori kryesore: Trajtimi sipas rregullave kombëtare, njohja dhe *passporting* (*National Treatment, Recognition, and Passporting*).

Raporti përfshin edhe diskutime të hollësishme të sfidave kryesore dhe përvojave me të cilat përballen rregullatorët në zbatimin e rregulloreve ndërkufitare që veprojnë për letrat me vlerë, duke përfshirë se si rregullat kombëtare që zbatohen dhe influencojnë tregjet financiare globale ndërveprojnë me rregullatorët e huaj dhe standardet ndërkombëtare.

Për të lexuar këtë raport klikoni këtu:

<https://www.iosco.org/library/pubdocs/pdf/IOSCOPD466.pdf>